




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	13.03.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-783/18
PËR/ZA/TO:	z. Gani NEKAJ, Kryesues i Departamentit të Prokurimit në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale
CC:	z. Ramiz KRASNIQI, Drejtor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve - Hyundai "

I nderuari z. NEKAJ,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " **Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve - Hyundai** ", me numër të prokurimi: 318-18-992-221, me nr. të brendshëm: 318-18-011-221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve - Hyundai** ", me numër të prokurimi: 318-18-992-221, me nr. të brendshëm: 318-18-011-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), me datë 12.03.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokoll: *AKK-03-03-783/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "*Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve - Hyundai*", me numër të prokurimi: *318-18-992-221*, me nr. të brendshëm: *318-18-011-221*, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi** ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike kornizë të llojit shërbime me një Operator ekonomik, me vlerë të mesme.

Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka vërejtur se tek rubrika *III.2.4. Kapaciteti teknik/profesional tek kërkesat 4 dhe 5*, Autoriteti Kontraktues tek kërkesa 4 ka kërkuar referenca - eksperiencë në servisimin dhe riparimin e automjeteve me ndonjë Institucion Publik apo Privat në 3 vitet e fundit (2016, 2017 dhe 2018), ndërsa tek kërkesa 5 është kërkuar Lista e kontratave kryesore dhe relevante të shërbimeve të ngjashme të Operatorit ekonomik të realizuara gjatë 3 viteve të fundit (2016,2017 dhe 2018). Kërkesa këto për të cilat Agjencia gjithashtu konsideron se nuk janë në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik më saktësisht me nenin 69 të këtij Ligji.

Sipas Legjislacionit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 4.2. parashihet se "për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të Operatorëve ekonomik, Autoritetet Kontraktuese mund të kërkojnë listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë".

Pra në këtë rast do duhej të kërkohej lista e kontratave bashkangjitur si dëshmi referencat mbi përfundimin e kontratave të ngjashme të shërbimeve **për vitet fiskale 2015,2016 dhe 2017**.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit dhe nenin 69 Kapaciteti teknik/profesional të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !